



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut , Barazi Gjinore,
Personat e Pagjetur dhe Peticione
Nr. 04/08
Prishtinë me 12 .mars 2008 në orën 13,00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

**I mbledhjes se Komisionit për të Drejtat e Njeriut ,Barazi Gjinore,
Personat e Pagjetur dhe Peticione**

Në mbledhje morën pjesë : Ismet Beqiri, kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujović, Nerxhivane Dauti, Naim Rrustemi, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Vezira Emrush, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati anëtarë.

Komisioni për këtë mbledhje kishte ftuar:

z. Hilmi Jashari ushtruesi i detyrës se Avokatit të Popullit,

Kryetari hapi mbledhjen dha pasi e përshëndeti ushtruesin e detyrës se Avokatit të Popullit z. Helmi Jashari ,i njoftoi të pranishmit me pikat e rendit të ditës

Komisioni me propozimin e Kryetarit, miratoi :

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Takim pune me ushtruesin e detyrës se Avokatit të Popullit z. Hilmi Jashari ,
3. Shqyrtimi i disa peticioneve ,
4. Të ndryshme

U hap shqyrtimi për pikën e parë

- 1 Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
Pasi nuk pati vërejtje ai u miratua
- 2 Takim pune me ushtruesin e detyrës se Avokatit të Popullit z. Hilmi Jashari**

Kryetari, pasi që i përshëndeti anëtarët i dëshiroi mirëseardhje z. Jasharit dhe nënvizoi : Nga titulli i Komisionit keni vërejtur se cilat fusha të veprimit i përfshin që bazohet në katër fusha , të cilat janë të rëndësishme për punën e Kuvendit të Kosovës e këto janë : të drejtat e njeriut, barazia gjinore, personat e pagjetur dhe peticionet. Prandaj,lidhur me këtë hap debatin.

z. Helmi Jashari - në fillim e përshëndeti kryetarin për ftesën që iu është bërë dhe shtoi: Avokati Popullit është një mekanizëm i Kuvendit dhe si tillë mund të ekzistojë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Me tutje ceku : Avokati i Popullit ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që t'i lejohet zhvillimi i një debati lidhur me rekomandimet e ofruara pasi i cilësoi si të nevojshme të cilat përfshihen në raportin vjetor për vitin 2006-2007,por mjerisht kjo nuk ka hasur në mirëkuptim nga Kuvendi. Arsyet e mos lejimit të debatit deri me tani Kryesia e Kuvendit nuk i ka shpjegua gjë që për këto edhe Këshilli e Sigurimit është i njoftuar. Sa u për ketë raporteve u tha se ato iu dërgohen në institucioneve bashkë me rekomandimet në fushat përkatëse duke u propozuar alternativa në zgjedhjen e tyre . Ai kërkoi nga Komisioni parlamentar të grisë çështje e implementimit të rekomandimeve nga Qeverisa e Kosovës. Në fushëveprimin e Avokatit të Popullit ai i ngriti disa fusha siç janë : Çështja e të drejtave të njeriut – dhe u tha se këto po shkelen si pasojë e mos sundimit të ligjit në Kosovë, çoftë në mungesë e ekzekutimit të procedurave gjyqësore si që është rasti të eksproprijimet ,apo mos kryerja e punëve me kohë nga ana e zyrtareve ose mos njohja me ligje qytetareve dhe shkelje serioze kriminale të kryera që nuk përndiqen si duhet dhe janë të lidhura me krimin e organizuar.

Në fushën sektorit ligjor ka ngecje dhe vazhdimisht në raporte e kemi theksuar që janë në nivelin e standardeve ndërkombëtare. Pra vuri se mungesa e qartësisë dhe transparencës krijojnë pasiguri. Ai ceku se Kosova po ballafaqohet me një kaos të legjislacionit jo të harmonizuar të vjetra disa po krijojnë huti . Në vazhdim ne vija trasha foli për funksionin e gjykatave ne Kosovë të cilat nuk janë ne nivelin e duhur . Ai nënvizoi se - për të njëjtën çështje ka dy aktgjykime dhe pasojë e kësaj ka pasiguri të qytetaret. Në këtë kontekst u cek edhe korrupsioni dhe reformat në gjyqësor janë të domosdoshme . Pra, përshtatshmëria e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut duke i cek një mori të konventave evropiane që rregullojnë këtë fushë. Sa i përket administratës publike ka të meta për mos realizimin e të drejtave të qytetareve duke kërkuar një rivlerësim të sajë .

Ismet Beqiri - e falënderoi parafolësin lidhur me punë që është duke kryer dhe e njoftoi me ekspertet që ka komision për fushat përkatëse dhe beson në aftësitë në zgjidhjen e peticioneve. Pra , fusha e drejtave të njeriut është deti . Avokati i Popullit do të ju jep përparësi të veçanet pohimeve për shkelje të rënda ose sistematike ,pohimeve në bazë diskriminimit ,duke përfshirë diskriminimin ndaj komuniteteve dhe anëtareve të tyre .Ai tha sa ishte kryetar ka pasur ankesa dhe ishte i mendimit për themelimin e një zyre në përputhje me legjislacionin aktual të marrë dhe të hetojë ankesat,të vëzhgojë të marr masa parandaluese ,të bej rekomandime dhe jap këshilla për çdo njërën prej këtyre heshtjeve. Kontest te kompetencave komisioni ka rol të monitoruesit në fushat përkatëse , do të

shtrijmë në të gjitha institucionet Republikës së Kosovës duke përfshirë e Avokatin e Popullit.

Sanije Alijaj e çmoi lartë diskutimin e z. Jasharit dhe shtoi : Se shpejti do të plotësohet vendi i zbraztë i Avokatit të Popullit dhe pres kontakte më të afërta duke mos përjashtuar, paraqitjen e raporte Kuvendit të Kosovës . Ajo në fushën e të Drejtave të Njeriut e veçoi të drejtat e punës të cilat cenohen nga ana e institucioneve qoftë fushën publik apo private. Sa i përket, bashkëpunimi mes Avokatin e Popullit dhe Komisionit e mirëpret. Në fund diskutoi për barazinë gjinore dhe njëkohësisht pyeti sa është mbrojtur femra.

Vezira Emrush – duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve shtroi pyetjen : Në këto 8 vitet e fundit sa kërkesa i kanë arritur zyrës tuaj, nga cila Komunë si dhe natyra e tyre ?

Nerxhivane Dauti – e çmoi pozitive punën e z. Jashari dhe apeloj për bashkëpunim të mirfillt në mes Komisionit dhe Avokatit Popullit. Duke u ndërlidhur lidhur me diskutimin e tij shtoi - në mënyrë kronologjike është ofruar një pasqyrë lidhur me punën e bërë dhe përgjigjet e dhëna . Me tutje ceku, nga viti 1999, keni dhënë kontribut në zgjedhjen problemeve e me thekës për fëmijë. z. Hilmi Jashari iu përgjigj pyetjeve të shtruara që u mirëpritën .

3. Shqyrtimi i disa peticioneve

Komisioni e ngarkoi Nerxhivane Dauti , me disa shkresa me qëllim të zgjedhjes së tyre.

z.Hilmi Jasharit ,iu dorëzua një kopje evidencës se peticioneve

Prandaj, ishte konstatim për vazhdimin e bashkëpunimit në mes Komisionit dhe Avokatit të Popullit

Mbledhja përfundoi në orën 13,35.

Procesverbalin e hartoi
Rrahim Demaj zyrtar i lartë ligjor

Kryetari i Komisionit
Ismet Beqiri

